

Angazhohu Monitoro Vepro



Suplement nga Grupi Monitorues i Këshillit Bashkiak, Pogradec Mars 2012

Demokraci do të thotë pjesëmarrje

Të mos mbyllësh mendjen dhe veçanërisht sytë.

Ngri zërin dhe mos hiq dorë, mos u dorëzo,
....edhe nëse je i vetëm!



Në foto (lart): Grupi i Monitorimit gjatë monitorimit të Këshillit Bashkiak, Pogradec dhe trajnimeve
Në fotot (poshtë): Grupi i Monitorimit gjatë trajnimeve për buxhetimin me pjesëmarrje

Një mundësi për
pjesëmarrje në
vendimmarrje

Këshilli bashkiak, vendi
ku merr jetë qyteti dhe
qytetarët

Pjesëmarrja në
vendimmarrjen e qeverisjes
vendore

Lexoni në faqen 7, 8, 9



“Gjithçka në një vend demokratik fillon me lejen nga publiku dhe ekziston nga miratimi publik

Një mundësi për pjesëmarrje në vendimmarrje -ligji për bashkëpronësitë në ndërtesat e banimit-

Shkruar nga Ilir Buzali

Bashkitë kanë gjetur një formulë standarde për të realizuar kërkesën e ligjit mbi pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje. Kur ndodhen para kërkesës këmbëngulëse dhe monitorimit (sidomos nga konsulentë ndërkombëtarë) për të bërë transparencë dhe konsulta me qytetarët, sigurohen që të organizojnë një cikël takimesh. Në këto takime pjesëmarrës janë qytetarë të zellshëm për të afishuar mendimet dhe sugjerimet e tyre. Zakonisht janë qytetarë që përfaqësojnë vetëm vetveten dhe pranojnë të bëhen pjesë e një shou mediatic. Takimet filmohen e transmetohen dhe bashkia e quan të kryer detyrimin për transparencë dhe pjesëmarrje qytetare në vendimmarrje.

Këto aktivitete, ashtu siç nisen, ashtu dhe katandisen; harrohen, pa lënë prapa asnjë gjurmë, pa krijuar asnjë produkt. Individët pjesëmarrës në takime nuk kanë fuqinë për të ndjekur zbatimin e sugjerimeve të tyre, apo vendimeve që merren.

Në fakt këto konsultime s'i vlejné askujt, pushteti vendor vazhdon të punojë me “kokën e vet”, pa i njohur realisht kërkesat e komunitetit. Qytetarët sigurisht s'përfitojnë gjë, ndonëse mund të kenë shumë për të thënë.

Është thjesht një alibi për të justifikuar prioritetet kur s'përbëjnë prioritet, për të justifikuar shpenzimet aty ku nuk është nevoja. Disi më ndryshe është kur takimet organizohen nga shoqëria civile, me projekte konkrete e të detajuara, me objektiva, që ndjekin në proces punën e qeverisjes vendore.

Megjithatë nëse ekziston vullneti i mirë, gjenden edhe rrugët

për tërheqjen e mendimit të komunitetit, për të realizuar pjesëmarrjen në vendimmarrje. Një rast i tillë është ligji nr.10112, datë 27.4.2009 “Mbi administrimin e bashkëpronësive në ndërtesat e banimit”. Në datën 16.6.2010 u miratua VKM nr.447, me rregulloren tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, në zbatim të këtij ligji. Është një eksperiencë e zbatuar tashmë në qytetin e Tiranës dhe që pritet të shtrihet në qytetet e tjera.

Rregullorja tipe administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit detajon përbërjen e asamblesë së bashkëpronarëve, zgjedhjen e kryesisë, kujdestarit apo administratorit, përgjegjësitë e secilit, kontributet financiare për shpenzime të përbashkëta dhe rregulla të tjera të bashkëjetesës. Me pak fjalë asambleja e bashkëpronarëve zakonisht formohet nga pronarët e njësisive të banimit që përdorin një hyrje/shkallë/ashensor të përbashkët. Asambletë e pallateve do të zgjedhin kryesinë me 1 deri 7 anëtarë, në vartësi të numrit të apartamenteve, si dhe kryetarin. Do të ketë në dispozicion një buxhet të vogël, me kontributet e bashkëpronarëve, për të paguar kujdestarin apo për shpenzime të ndryshme. Në rregulloren tip theksohet se “Kryesia është përfaqësuese dhe mbrojtëse e interesave të asamblesë përpara çdo pale të tretë, përpara çdo instance të gjyqësorit e çdo organi tjetër shtetëror.”

Dihet që në ditët e sotme në qytete shumica e banorëve jetojnë në ndërtesa me më shumë se një pronar, sidomos nëpër pallate banimi. Duke pasur parasysh këtë fakt duket edhe më pa kuptim

konsultimi i qeverisjes vendore me individë të paorganizuar. Sigurisht qytetarë të veçantë që kanë probleme specifike, duhet t'i kenë të hapura rrugët për t'u shprehur, për t'u ankuar apo për të sugjeruar.

Por problemi thjeshtohet me zbatimin e rregullores së bashkëpronësisë. Tjetër përgjegjësi ka para komunitetit kryetari i kryesisë apo kryesia e asamblesë së një pallati. Jo vetëm përgjegjësi, por edhe njohje të kërkesave të bashkëpronarëve. Përballë këshilltarëve apo administratorëve të qeverisjes vendore, mund të dalin të zgjedhurit e këtyre asambleve, pra të pallateve, me më shumë autoritet dhe peshë se sa individët që përfaqësojnë vetveten.

Është koha që qytetarët që banojnë në pallate të mësohen të bashkëjetojnë mbi rregulla të respektuara nga të gjithë, të mbajnë pastër mjediset e përbashkëta, të mos shkundin tapetet në kokat e njëri-tjetrit, të mos shqetësojnë fqinjët, të mos prishin qetësinë, të zhduqojnë kur shkaktojnë dëmtime të mjedisëve të përbashkëta, të pranojnë të përfaqësohen dhe “të arbitrohen” nga fqinji i zgjedhur kryetar asambleje në pallat etj.

Ana tjetër e medaljes: nëse qeveritarët vendorë kanë vërtet vullnetin e mirë për t'u konsultuar me komunitetin, s'ka pse të sajojnë “qytetarë aktivë”, por mund të kontaktojnë me bordet e bashkëpronarëve apo me kujdestarët e pallateve të banimit, këta të zgjedhur të “demokracisë së vogël”. Këta të fundit kanë informacionin e duhur, por edhe interesin për të zgjidhur shqetësime të përbashkëta si pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi etj. Jo vetëm

kaq, por ata kanë edhe mundësinë të ndjekin në proces zgjidhjen e problemeve. Duke bërë presion pranë organeve të qeverisjes vendore, ata i kthejnë objektivat në rezultate.

Kështu problemet e zonave të ndryshme të banimit nuk mbarten nga njëri vit në tjetrin. Nuk do të ndodhë ajo që ndodh shpesh sot: qytetarët ngrenë zërin e kërkojnë një shërbim, bashkia i përcjell me premtime, pastaj përsëri ankesa e përsëri premtime. E kështu me radhë derisa qytetarët mërzhiten e humbin besimin tek qeverisja vendore. Kjo sjell dhe shkëputjen që vihet re midis palëve në këtë proces.

Të zgjedhurit vendorë do të bëhen më të përgjegjshëm në marrëdhëniet me komunitetin, sepse do t'i kenë vazhdimisht përballë “të zgjedhurit” e pallateve. Kështu shpresohet që demokracia lokale të funksionojë më mirë, të dy palët, zgjedhësit dhe të zgjedhurit të luajnë rolin që u takon.

Demokracia është pjesëmarrje. Qytetarët votojnë dhe zgjedhin këshillat dhe kryetarët e bashkisë. Këta bëhen administratorë të qytetit. Nga ana tjetër qytetarët zgjedhin kryesinë e bashkëpronarëve të banesave. Nëse organet e zgjedhura të bashkisë nuk funksionojnë si duhet, s'mund të pritet të vijnë zgjedhjet e tjera. Nuk është zgjidhja më e mirë ndëshkimi me votë, për të hequr një palë të zgjedhur e për të vënë një palë tjetër. Zgjidhja më e mirë do të ishte që të vihen në lëvizje ata që kanë aktualisht mandatin e qeverisjes lokale.

Ligji nr.10112, datë 27.4.2009 “Mbi administrimin e

Vijon në faqen 7

Monitorimi - Një proces i domosdoshëm dhe jetik për demokracinë lokale

Këshilli bashkiak, vendi ku merr jetë qyteti dhe qytetarët

Albina Pajo, gazetare

Në kulturën demokratike të më shumë se 20 viteve të fundit institucionet vendore, bashkitë dhe komunat përpos administratës së tyre kanë një hallkë mjaft të rëndësishme të punës së tyre këshillin bashkiak, forumin e mirëfilltë vendimarrës që e lidh me qytetin dhe qytetarët.

Në përputhje me ligjin e funksionimit të pushtetit lokal këshillat bashkiake kanë tani rolin e institucioneve të mirëfillta vendimarrëse, ku zëri i qytetarëve përcillet nëpërmjet të zgjedhurve, këshilltarëve të forcave të ndryshme politike.

Prej sa e sa vitesh Këshilli Bashkiak në Pogradec përbëhet nga 25 këshilltarë ku në përfundim të betejave politike herë dominon njëra e herë tjetra forcë politike.

Po sa transparente janë mbledhjet e këshillit bashkiak? Sa janë të ndjeshëm vetë qytetarët të bëhen pjesë e tyre? Janë këto pyetje përgjigjet e të cilave plotësojnë njëra tjetrën.

Në fakt me ligj mbledhjet e këshillit bashkiak janë të hapura për publikun që do të thotë se çdo qytetar ka të drejtë të jetë pjesë e tyre, të njihet me pikat e rendit të ditës e sigurisht të diskutojë për ato probleme që e shqetësojnë. Po sa realisht ka ndodhur kjo? Në përvojën time më shumë se 13 vjeçare pak ose aspak ka ndodhur kjo gjë.



Në sallën e këshillit bashkiak kanë qenë të rralla rastet kur vetë qytetarët janë bërë pjesë e diskutimeve me karakter publik apo të kenë ngritur zërin për probleme që shqetësojnë qytetin dhe komunitetin si shërbimet, taksat, transparencën e buxhetit dhe të ardhurave, ndriçimi, gjelbërimi, turizmi, sporti e shumë e shumë si këto. Për të qenë realistë një lloj ndjeshmërie është vërejtur vetëm kur qytetarët mund të kenë pasur vendime e projekt vendime që mund t'u interesojnë atyre.

E drejta e informimit publik sigurisht është e sanksionuar me ligj, që do të thotë se qytetarët kanë të drejtë të informohen

për çfarë ata duan të dinë në interes të qytetit e zhvillimit të tij. Por duket se problem nuk qëndron thjesht këtu. Pyetja shtrohet sa e shfrytëzojnë qytetarët këtë të drejtë që buron nga ligji. Nga ana tjetër sa transparent është vetë këshilli bashkiak si institucion vendimarrës përballë qytetarëve. Këto janë sigurisht dy çështje që

konvergojnë në një pikë nëse ekziston vullneti i të dy palëve.

E ndodhur pothuaj në çdo mbledhje të këshillit bashkiak në vendin tim si gazetare, prej disa seancash shoh që nuk jam e vetme. Një grup të rinjsh e të rejash monitorojnë takimet e këshillit çdo muaj njihen me vendimet që merren e dëgjojnë çdo diskutim duke u bërë kështu qoftë edhe vetëm me prezencën e tyre pjesë e transparencës për të cilën më shumë flitet se bëhet realisht gjë. Janë sigurisht një pjesë e vogël e qytetit që dëgjojnë e vëzhgojnë gjithçka thuhet e vendoset në këto mbledhje. Së paku ata janë këtu, po të jenë më tepër është sigurisht më mirë, për të gjithë ne.

Një mundësi për pjesëmarrje në vendimmarrje

Vijon nga faqja 6

bashkëpronësive në ndërtesat e banimit” krijon premisa që përfaqësues nga komunitete më të vogla, ato të bashkëpronarëve, të ushtrojnë presion dhe të ndjekin zbatimin e vendimeve. Nga ana e tyre këta përfaqësues të bashkëpronarëve vihen nën presion nga vetë bashkëpronarët për të mos i lënë pas dore kërkesat e tyre ndaj bashkisë. Skema e funksionimit të demokracisë lokale duket se kështu funksionon më mirë. Mbetet vetëm të shihet në praktikë zbatimimi i këtij ligji, që të mos ndodhë si me përvojën jo të mirë të disa ligjeve të tjera, të mbetura në letër.



Benjamin Franklin "Në këtë botë asgjë nuk mund të quhet e sigurt përveç vdekjes dhe taksave"

Buxheti me pjesëmarrje

Buxheti është dokumenti kryesor i shtetit, program financiar vjetor që miratohet nga kuvendi, i cili përbëhet nga:

- * Buxheti Qendror
- * Buxhetet e Pavarura
- * Buxheti i Njësive të qeverisjes vendore (buxheti lokal)

Buxheti lokal përbëhet nga pjesa e buxhetit të pavarur dhe pjesa që financohet nga buxheti i shtetit. Ai përfshin:

1. Të ardhurat (sa do të mblidhen dhe si)
2. Shpenzimet (sa do të shpenzohet dhe për çfarë)
3. Pjesa e buxhetit që financohet (huatë)

Kërkesa për një buxhet që hartohet dhe zbatohet në mënyrë të përgjithshme dhe me nivelin më të lartë profesional, është kërkesë qytetare.

Qytetarët dhe tatim-paguesit kanë një rol të pazëvendësueshëm në kontrollin e parave të buxhetit. Kuptohet që ky rol kushtëzohet nga mundësia dhe aftësia e tyre për të marrë informacion rreth tij.

Në bazë të Ligjit nr.8652 datë 31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nenit 34:

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për publikun.

Çdo qytetar lejohet të ndjekë ato sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e Këshillit.

Njoftimi për to bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media.

Këshilli me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve vendos rastet kur mbledhjet bëhen të mbyllura.

(neni 35) Këshilli Bashkiak para shqyrtimit dhe miratimit të akteve të tij zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë të cilat janë të detyrueshme për rastet:

1. Kur miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij

ÇFARË ËSHTË BUXHETIMI ME PJESËMARRJE

Është një mekanizëm i thjeshtë që përfshin të gjithë komunitetin, burra dhe gra, shtresat tradicionalisht të përjashtuara në sigurimin e aksesit ndaj fondeve publike dhe në procesin e vendimmarrjes.

2. Vendos për taksat dhe tarifatat vendore (etj)

Format e këtyre seancave të këshillimit janë takimet e hapura me banorët, me specialistët, me institucionet e interesuara dhe organizatat joqeveritare.

Aktet e këshillit Bashkiak afishohen në vende publike dhe informimi i publikut bëhet në bazë të Ligjit nr.8503 datë 30/06/1993 "Për të drejtën e informimit të dokumentave zyrtare".

Mbledhja e të ardhurave realizohet nëpërmjet politikës fiskale e cila konsiston në vendosjen dhe ndryshimin e taksave dhe shpenzimeve dhe që përdoret për të nxitur sigurinë ekonomike.

Rëndësia e taksave dhe tatimeve shprehet dhe tek thënia e presidentit amerikan Benjamin Franklin:

"Në këtë botë asgjë nuk mund të quhet e sigurt përveç vdekjes dhe taksave".

Qëllimi kryesor i mbledhjes së taksave është mbledhja e të ardhurave për të paguar mallrat dhe shpenzimet publike që ofron shteti.

Këshilli bashkiak kategorizon taksat vendore brenda

kategorive minimale të bazës së taksës.

Ai vendos nivelin e taksës, përcakton numrin e kësteve të pagimit të saj dhe afatet e kryerjes së tyre.

Në taksat vendore përfshihen 9 lloje njëra prej të cilave është dhe Taksa Vendore Mbi Biznesin e Vogël.

Çdo subjekt që kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullimi) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 (tetë milion) lek, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël.

Kjo lloj taksë është një detyrim vjetor (1Janar - 31Dhjetor).

Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për cdo kategori minimale të bazës së taksës (aneksi 5), në kufijtë plus-minus 30% të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse dhe për cdo interval të qarkullimit, në përputhje me udhezimet përkatëse. (neni 11 i Ligjit nr.9632 datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore")

Këshilli Bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksës për taksapaguesin, veprimtaria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcës madhore. Ky lehtësim është i përkohshëm, kohëzgjatja përcaktohet nga Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Taksa paguhet në katër këste të barabarta.

Taksapaguesi ka të drejtën e ankimit për kualifikimin si Biznes i vogël apo për vlerësimin e taksës. Ky ankim bëhet brenda 30 ditëve fillimisht tek Kryetari i Bashkisë dhe më pas në Gjykatë.

Përgatiti: Klea VAKO
(juriste)



Pjesëmarrja në vendimmarrjen e qeverisjes vendore

Kleda VAKO, juriste

Pushteti vendor në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen sa më afër shtetasve nëpërmjet:

1-njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë

2-zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë

3-nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore

Këto janë tre nga misionet kryesore të pushtetit vendor, të cilat realizohen në bashkëpunim midis organeve të tij: organi përfaqësues që është Këshilli dhe organit

ekzekutiv (kryetari të qeverisjes vendore).

Një nga të drejtat e qeverisjes vendore është e drejta e kryerjes së veprimtarive ekonomike nëpërmjet përmbushjes së funksioneve publike në interes të bashkësisë që përfaqësojnë.

Qeverisja vendore financohet përveç të tjerave, nga të ardhurat që sigurohen nga taksat dhe tatimet vendore, të cilat mblidhen nga bashkësia e komunitetit që ajo përfaqëson.

Çdo njësi e qeverisjes vendore ka autoritet të plotë për qëllimet



dhe mënyrat e përdorimit të të ardhurave që krijohen nga taksat dhe tatimet vendore.

Këto janë përcaktime ligjore të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti me pjesëmarrjen e bashkësisë së komunitetit në vendimmarrjen e organeve të qeverisjes vendore.

Pjesëmarrja në vendimmarrjen e qeverisjes vendore është një çelës i rëndësishëm i mirëfunksionimit të pushtetit dhe administrimit vendor.

Kjo pjesëmarrje është njëkohësisht një e drejtë dhe

detyrë e bashkësisë komunitare, e cila sjell realizimin e funksionit të mirëqeverisjes vendore.

Komuniteti ka të drejtën për t'u informuar në lidhje me vendimmarrjen e qeverisjes vendore dhe detyrën për të qenë pjesë e kësaj vendimmarrje.

Organet e qeverisjes vendore e realizojnë këtë pjesëmarrje në mënyrat e mëposhtme:

1.Zhvillimit të seancave të këshillimit me bashkësinë duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, me specialistët e fushave

të ndryshme, me institucionet e interesuara, organizatat joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

2.Zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Këshillit bashkiak ose komunal. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjet e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga vetë këshilli dhe në

media.

3.Afishimit të akteve të këshillit në vende publike të caktuara brenda territorit të komunës ose bashkisë.

4.Informimit të publikut në çdo komunë apo bashki në bazë të ligjit nr.8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" si dhe rregullave të përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Të gjitha këto sa më sipër janë përcaktime ligjore, të cilat mbeten të tilla nëse nuk realizohen nga komuniteti jetën e përditshme.

Çfarë është Buxheti vendor?

Një ndër funksionet kryesore të njësisë të qeverisjes vendore është përcaktimi se si do të shpërndahen burimet që plotësojnë në mënyrën më të mirë të mundshme nevojat e qytetarëve të tyre.

Si në shumë vende të tjera, edhe në Shqipëri kjo ndodh gjerësisht nëpërmjet procesit të buxhetit vjetor.

BUXHETI VENDOR ËSHTË :

- ✓ Një process nëpërmjet të cilit zbatohen vendime themelore lidhur me pjesën e funksioneve publike që janë nën përgjegjësinë e njësisë të qeverisjes vendore
- ✓ Një dokument që përmban të gjitha të ardhurat e pritshme dhe shpenzimet e propozuara për secilën nga funksionet e njësisë së qeverisjes vendore për një periudhë njëvjeçare
- ✓ Një mjet politikash që udhëheq alokimin e burimeve të kufizuara ndërmjet përparësive konkurruese
- ✓ Një mjet menaxhimi që ndihmon në transformimin e vendimeve në programe specifike
- ✓ Një mjet komunikimi që ndihmon për informimin e këshillit, qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar në çështjet buxhetore të komunitetit, zgjedhjet dhe tendencat
- ✓ Një metodë e reagimit ndaj kërkesave të qytetarëve dhe preferencat për shërbimet vendore
- ✓ Një metodë e ushtrimit të kontrollit komunitar mbi paratë publike
- ✓ Një formë kontabiliteti

PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT KOMUNAL DHE BASHKIAK

Neni 23

MËNYRA E ZGJEDHJES

Këshilli komunal dhe bashkiak përbëhen nga këshilltarë të zgjedhur sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 24

NUMRI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMUNAL DHE BASHKIAK

1. Numri i anëtarëve të këshillit komunal dhe bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:

Komunat dhe bashkitë deri në 5 000	banorë	13 anëtarë
“ “ 5 000 - 10 000	banorë	15 anëtarë
“ “ 10 000 - 20 000	banorë	17 anëtarë
“ “ 20 000 - 50 000	banorë	25 anëtarë
“ “ 50 000 - 100 000	banorë	35 anëtarë
“ “ 100 000 - 200 000	banorë	45 anëtarë
Bashkia e Tiranës		55 anëtarë

2. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo komunë e bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet.

Neni 25

PAPAJTUESHMËRIA E FUNKSIONIT TË KËSHILLTARIT

- Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:
 - funksionin e kryetarit, zëvendëskryetarit të komunës ose bashkisë;
 - funksionin e sekretarit të këshillit komunal ose bashkiak;
 - funksionin e nëpunësit të administratës së komunës ose bashkisë përkatëse;
 - funksionin e deputetit.
- Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill komunal ose bashkiak.
- Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat që janë me njëri-tjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen dhe dhëndërin.

Neni 26

Mbledhja e parë e këshillit komunal ose bashkiak

- Këshilli komunal ose bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjes nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
- Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit komunal ose bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti.
- Në rast se asnjë nga subjektet e sipërpërmendura nuk e ushtron këtë të drejtë brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë këshilli mblidhet vetë brenda 10 ditëve.
- Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, të shpallur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore. Nëse nuk mblidhen më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret tri ditë më vonë, por jo më shumë se tri herë. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrje

- nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, këshilli konsiderohet i shpërndarë.
- Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë.
 - Në mbledhjen e parë të këshillit komunal ose bashkiak:
 - zgjidhet komisioni i mandateve;
 - miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
 - këshilltarët bëjnë betimin;
 - zgjidhet kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit;
 - zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen ata me mandatin e përfaqësimit.
 - Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij.

Neni 27

MANDATI I KËSHILLTARIT

- Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit.
- Dhënia dhe heqja e mandatit bëhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.
- Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.
- Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit, me propozimin e komisionit të mandateve kur:
 - ndryshon vendbanimin;
 - jep dorëheqjen;
 - krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji;
 - mandati nga ana e tij është marrë në mënyrë të parregullt;
 - humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate;
 - vdes;
 - nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;
 - dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;
 - këshilli shpërndahet nga organi kompetent.

Neni 28

BETIMI

- Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, këshilltarët betohen përpara këshillit me formulën e mëposhtme:

“Betohe, në emër të zgjedhësve që përfaqësoj, të mbroj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e saj. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të komunës ose bashkisë (emri i komunës ose bashkisë përkatëse) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.”
- Këshilltari që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, quhet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.

Neni 29

Të drejtat e këshilltarit

- Këshilltari nuk përgjigjet për mendime të shprehura, lidhur me çështje zyrtare gjatë ushtrimit të detyrës.
- Këshilltari shpërblehet për punën që kryen. Masa e shpërblimit vendoset nga këshilli përkatës mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë nga administrata e komunës ose bashkisë përkatëse, çdo lloj dokumentacioni për njohje të problemeve të juridiksionit të saj.
- Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit

PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT KOMUNAL DHE BASHKIAK

të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

Neni 30

KONFLIKT INTERESI

1. Këshilltari nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e aktit të këshillit kur ai vetë ose bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehrra, vjehrra, dhëndëri e nusja e tij, kanë interes pasuror ose çdo interes tjetër me çështjen që diskutohet në këshill.

2. Në çdo rast konflikti interesash zbatohen dispozitat skualifikuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

1. Këshilli komunal dhe ai bashkiak ushtron funksionet e tij qysh nga krijimi, sipas nenit 26, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

2. Mbledhjet e radhës të këshillit komunal ose bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.

3. Këshilli mblidhet jashtë radhe:

a) me kërkesën e kryetarit të komunës ose bashkisë;

b) me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të tij;

c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

4. Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.

5. Rendi i ditës miratohet nga këshilli.

“Në rendin e ditës përfshihen, me përparësi, propozimet për vendime të kryesive të fshatrave nën juridiksionin e komunës /bashkisë përkatëse”.

6. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm komunal ose bashkiak ushtron funksione të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.

7. Mbledhja e këshillit komunal ose bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 33 të këtij ligji.

8. Kur këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin.

9. Mbledhjet e këshillit fiksohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij, përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të këshillit.

Neni 32

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

Këshilli komunal ose bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

a) Miraton statutin e komunës ose të bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.

b) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këshillit.

c) Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit komunal ose bashkiak.

ç) Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së komunës ose të bashkisë, të njësive e institucioneve buxhetore në

varësi të komunës ose të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

d) Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose është bashkëthemelues.

dh) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.

e) Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

ë) Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të komunës ose bashkisë.

f) Vendos për taksat e tarifave vendore, si dhe nivelin e tyre.

g) Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.

gj) Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.

h) Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.

i) Zgjedh përfaqësuesit e këshillit komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut.

j) Vendos për dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit.

k) Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

l) Vendos për simbolet e komunës ose të bashkisë.

ll) Vendos për emërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucioneve dhe të objekteve në juridiksionin e komunës ose të bashkisë.

m) Jep tituj nderi dhe stimuj.

n) Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim te komuna ose bashkia.

Neni 33

VOTIMI

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.

2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

“3. Vendimet për rastet e parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i”, dhe “j” të nenit 32 të këtij ligji, merren me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit”.

4. Vendimet merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja “e” të këtij ligji.

5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave.

6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 34

MBLEDHJET E HAPURA

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara

PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT KOMUNAL DHE BASHKIAK

nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur.

Neni 35

SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T’U INFORMUAR

1. Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat “dh”, “e”, “f” dhe “k” të këtij ligji.

2. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

“2 / 1. Për këshillat komunale / bashkiake janë të detyrueshme seancat e këshillimit me kryetarët dhe kryesinë e fshatrave nën juridiksion, në përputhje me përcaktimet e bëra në shkronjat “ç”, “dh”, “e”, “f”, “k” dhe “ll” të nenit 32 të ligjit. Seancat e këshillimit, në këtë rast, shënohen në procesverbal.

3. Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Neni 36

KRYETARI I KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

1. Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit komunal ose bashkiak, zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet nga të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit.

2. Kryetari i këshillit kryen këto detyra:

- a) thërret mbledhjen e këshillit në përputhje me nenin 31 të këtij ligji;
- b) drejton mbledhjet e këshillit në përputhje me rregulloren e tij;

c) nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;

ç) kryen detyra të tjera të përcaktuara në rregulloren e këshillit.

3. Në mungesë të kryetarit të këshillit, detyrat e tij i kryen zëvendëskryetari.

Neni 37

SEKRETARI I KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli komunal ose bashkiak, mbi bazën e propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.

2. Sekretari i këshillit komunal ose bashkiak është përgjegjës për:

- a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
- b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve sipas rendit të ditës;

c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;

ç) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga këshilli komunal ose bashkiak;

d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;

dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.

3. Sekretari i këshillit komunal ose bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

Neni 38


SHPËRNDARJA E PARAKOHSHME E KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

1. Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave kur:

- a) nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore;
- b) nuk arrin të marrë vendim për miratimin e buxhetit brenda tre muajve nga data e përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji;
- c) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.

2. Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet edhe kur bëhet riorganizim me ndryshim kufijsh, sipas nenit 70 të këtij ligji.

3. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të shpërndarjes nga organi kompetent, në komunën ose bashkinë përkatëse organizohen zgjedhjet për këshillin, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.



“Publikimi i këtij materiali mbështetet financiarisht nga Zyra e Çështjeve Publike e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit Amerikan të Shtetit”